

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	VIDEO nga momentet e tmerrit, kamioni zë poshtë kalimtarin në rrugë, shoferi largohet dhe... Gazeta S hqip
ADRESA	https://gazeta-shqip.com/aktualiteti/video-nga-momentet-e-tmerrit-kamioni-ze-poshte-kalimtarin-ne-rruge-shoferi-largohet-dhe/
BURIMI	gazeta-shqip.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 00:58:38 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 23:44:55 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	40a1321302e56ef2286b6cb6f2556ed79e0bdd7b12aaa3cc11e717c6c84a0eaf
TEKSTI	1659bfb1e43c860bfc8b98e90311683cf8c61e6ce902cdc51b973d1851d0a4db
PAMJA	7e21dcc28f1b5af354acbf0f7b0fc0a34c25a4d8e17a0b9b74e34d848afa40b3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0d0861c112ebf2516815fde0f47d4635ff05e42d3b8deaa60898713670a6aad1
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f3a7f3b1840b8c1fdf37cf45c7cf9cf417896e420137132777a1bf295bf8fe5f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0d0861c112ebf2516815fde0f47d4635ff05e42d3b8deaa60898713670a6aad1>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET

VIDEO nga momentet e tmerrit, kamioni zë poshtë kalimtarin në rrugë, shoferi largohet dhe...



22:44 | 16 SHTATOR 2026

SHPERNDA ▾

Në këtë dokumentar, Inside Story ka analizuar statistika, dosje hetimore, ekspertiza aksidentesh dhe vendime gjyqësore me pasoja fatale, duke zbuluar faktorët që vazhdojnë të prodhojnë viktimë dhe nëse rrugët shqiptare po bëhen më të sigurta apo më vdekjeprurëse.

Në shumicën e rasteve, hetimet fokusohen te drejtuesi i mjetit. Por ekspertët e ligjit thonë se një hetim i tillë është i cunguar. Në shumë raste, aksidenti nuk lidhet vetëm me gabimin njerëzor. Mungesa e sinjalistikës, amortizimi i rrugës, ndriçimi i dobët apo infrastruktura problematike mund të kenë ndikuar drejtpërdrejt në pasojat tragjike. Megjithatë, këta elementë shpesh mbeten jashtë fokusit të hetimit.

“Një hetim nuk mund të fokusohet vetëm te mjeti që ka kryer aksidentin. Por duhet të fokusohet te të gjithë përdoruesit e rrugës. Dhe përdorues të rrugës janë këmbësorët, janë përdoruesit e mjeteve, janë drejtuesit e çdo motomjeti, dhe të gjithë këta elementë duket se anashkalohe dhe i bien shumë shkurt hetimeve të aksidenteve”, u shpreh ish-prokurori, Eugen Beci.

Por a mjafton gjithmonë të identifikohet shoferi për të kuptuar të vërtetën e një aksidenti?

Një video e siguruar nga Inside Story, e një aksidenti në Kamëz, tregon se përgjigjja nuk është aq e thjeshtë.

Pamjet dokumentojnë momentet e fundit të jetës së një të moshuari dhe një

dinamike që ngre pyetje serioze mbi mënyrën se si analizonen aksidentet rrugore.

Në pamje, trafiku vijon normalisht dhe asgjë nuk të bën të mendosh se brenda pak sekondash një person do të humbasë jetën.

I moshuari ndodhet në karrexhatë. Më pas ndodh momenti fatal.

Kamioni i dytë nis nga vendi ku ishte parkuar. Në dukje, drejtuesi vazhdon normalisht itinerarin. Nuk dallohet asnjë manovër shmangëse, asnjë frenim i fortë dhe asnjë reagim që të tregojë se ka konstatuar praninë e një trupi në rrugë që ndoshta mund të ishte ende gjallë.

Kamioni kalon mbi të moshuarin. Ajo që trondit më shumë nuk është vetëm përplasja. Është fakti se mjeti vazhdon rrugën.

Sipas informacioneve të siguruara nga Inside Story, drejtuesi i mjetit ka vazhduar punën normalisht deri në pikën e grumbullimit të skrapit ku ishte i punësuar.

Vetëm pas afro një ore, policia ka arritur ta lokalizojë.

Efektivët janë paraqitur në vendin e punës dhe e kanë ndaluar, duke e informuar se automjeti që ai drejtonte ishte përfshirë në një aksident fatal.

Automjetet e tonazhit të rëndë kanë kënde të vdekura shikimi, të njohura si “blind spots”, zona ku drejtuesi mund të mos ketë pamje të plotë të rrugës përpara apo anash mjetit.

Por, pikërisht për këtë arsye, ekspertët e sigurisë rrugore theksojnë se drejtuesit e këtyre mjeteve mbajnë një përgjegjësi edhe më të madhe gjatë qarkullimit në zona urbane ku lëvizin këmbësorë.

Pyetjet që ngrihen natyrshëm janë nëse viktimja ndodhej në një pikë të verbër të kamionit apo shoferi ishte i pavëmendshëm? Dhe, akoma më tej, a mund të ishte shmangur tragjedia?

Këto janë pyetjet që një hetim i plotë duhet t’u japë përgjigje.



“Unë i mësoj shumë faktit të procesverbalit të vendit të ngjarjes, aty ku
në gjithë, mbledhja e të gjitha provave dhe radikutim kamerave. Sëra

me gjatësinë, merrimja e të gjitha provave dhe përdorimi i kamerave. Sepse ato, edhe sikur një ekspert apo grup ekspertësh të jenë të paaftë apo duan të ndryshojnë një fakt të caktuar, këto elementë e bëjnë çdo palë të interesuar, edhe atë që akuzohet padrejtësisht si fajtor në aksident, që të ketë mundësi ta kundërshtojë, që të ketë mundësi të bëjë një akt alternativ dhe, në rastin e kamerave, pastaj mund ta vërtetojë edhe qartësisht se si ka ndodhur aksidenti”, u shpreh Gedeon Dudushi, ekspert i sigurisë rrugore.

Rasti i Kamzës, ne e zbuluam përmes kamerave, tregon se aksidentet nuk janë gjithmonë aq të thjeshta sa duken në procesverbalet e para. Shpesh, pas një përplasjeje fshihen rrethana, veprime dhe mosveprime që duhen analizuar sekondë pas sekonde.

“Në një hetim të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor me pasojë vdekjen ose me pasojë dëmtimin e disa shtetasve është akti i ekspertimit autoteknik dhe akti i ekspertimit mjeko-ligjor. Këto janë dy elementët, të cilët duket se i kanë bërë “dembelë” prokurorët, për faktin e thjeshtë se shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor nuk është një marrëdhënie e drejtpërdrejtë dhe e vetme vetëm e drejtuesit të mjetit dhe këmbësorit”, u shpreh ish-prokurori, Eugen Beci.

“Ndikon shumë kultura rrugore, ndikon shumë kultura e qytetarëve për ndjekjen e rregullave të qarkullimit, qoftë edhe kur janë këmbësorë që kalojnë vend e pa vend. Nuk kalojnë në vijat e bardha, nuk kalojnë kur është semafori jeshil, por e trajtojnë veten e tyre si të lirshëm në momentin që janë pa automjet dhe si persona që nuk mund të gjobiten sepse nuk kanë praktika të shumta”, u shpreh avokati, Bledar Meminaj./Top Channel



GAZETA SHQIP

Rreth nesh
Marketing
Newsletter
Mundësi Punësimi
Kontakt

TOP ALBANIA RADIO

News
Shows
Video
Podcasts

MORE

Top Channel
TimeOutTirana
Top Music Awards

SOCIAL



Newsletter

Regjistrohuni

[Privacy Policy & Terms of Use](#) | [Cookie Policy](#)

gazeta shqip